

Njoftim i përqendrimit me të cilin SALUS -tregti me produkte farmaceutike, mjekësore dhe produkte të tjera, d.d., Slloveni fiton kontrollin mbi Medorion d.o.o. për shërbime shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, Kroaci

(lënda nr. 08-92/2023)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 05.07.2023, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin **SALUS- tregti me produkte farmaceutike, mjekësore dhe produkte të tjera, d.d.**, Litostrojska cesta 46A, 1000 Lubjanë, Slloveni fiton kontrollin mbi **Medorion d.o.o. për shërbime shoqëri me përgjegjësi të kufizuar**, Rruga Janka Drashkoviqa 5, 10430 Samobor, Republika e Kroacisë.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre të biznesit:

SALUS -tregti me produkte farmaceutike, mjekësore dhe produkte të tjera, d.d., (Salus) është shoqëria mëmë e Grupit të Kompanive Salus (" Grupi Salus "). Grupi Salus gjeneron shumicën e të ardhurave të tij përmes ndërmarrjeve-bijë të tij SALUS, tregti me shumicë d.o.o. ("SALUS tregti me shumicë") dhe Sanolejbor d.d. ("Sanolejbor"), aktiviteti kryesor i të cilit është tregtia me shumicë (Salus dhe Sanolejbor) dhe tregtia me pakicë (Sanolejbor) me barna, produkte farmaceutike, ndihma mjekësore, pajisje dhe materiale mjekësore. Shoqëritë brenda Grupit Salus ofrojnë gjithashtu shërbime magazinimi, rregullatorë, shërbime farmakovigjilence, marketing dhe promovim farmaceutik, farmakoekonomi.

Në Maqedoninë e Veriut, Grupi Salus është aktiv përmes ndërmarrjes- bijë Carso Pharm, shpknj Ilindenit, e cila është aktive në përfaqësimin dhe tregtimin e markave tregtare të prodhuesve kryesorë të produkteve farmaceutike.

Medorion d.o.o. është aktive në shpërndarjen e barnave për sëmundje të rralla dhe ka arritur vetëm qarkullim të parëndësishëm në Maqedoninë e Veriut në vitin 2022 nga shitjet tek klientët e saj në Maqedoninë e Veriut. Medorion nuk ka mjete në Maqedoninë e Veriut. Aktivitetet e saj në Maqedoninë e Veriut janë kryesisht të përqendruara në hulumtimin e tregut, duke krijuar ndërgjegjësim për sëmundjet e rralla dhe produktet e disponueshme, si dhe edukimin e profesionistëve të kujdesit shëndetësor mbi temën e sëmundjeve të rralla. Medorion nuk ka një rrjet shpërndarës në Maqedoninë e Veriut, qarkullimi i saj krijohet nga shitjet e rastësishme për një klient.

Sipas parashtresës të njoftimit si treg relevant për vlerësimin e përqendrimit në fjalë mund të përcaktohet tregu me shumicë i barnave të destinuara për trajtimin e sëmundjeve të rralla dhe të rënda në Maqedoninë e Veriut.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen

edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

23.06. 2023